



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.06.2022, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Nasip Naço- kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”. (*Komision për dhënie mendimi.*)

Marrin pjesë:

Nasip Naço, Xhemal Qefalia, Ferdinand Xhaferraj, Antoneta Dhima, Luan Duzha, Denis Deliu, Ilirian Pendavinji, Vullnet Sinaj, Isuf Çelaj, Lindita Metaliaj, Kasëm Mahmutaj dhe Klevis Xhoxhi.

Mungojnë:

Paulin Sterkaj, Toni Gogu, Bardhyl Kollçaku, Pranvera Resulaj, Agron Çela, Enkelejd Alibeaj, Ervin Salianji, Flamur Noka dhe Luan Baçi.

Të ftuar:

Hantin Bonati – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Kledia Ngjela – Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Lilika Radovicka – Drejtore e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Maksim Et’hemaj – Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil

Edlira Kraja – Drejtore Juridike e Autoritetit të Aviacionit Civil

HAPET MBLEDHJA

Nasip Naço – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Sigurinë Kombëtare me rend dite shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Ky projektligj është miratuar në parim në mbledhjen e kaluar, kurse sot do të zhvillojmë diskutimin nen për nen.

Të ftuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës kemi zotin Hantin Bonati, zëvendësministër; zonjën Kledia Ngjela, drejtoreshë e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë; zonjën Lilika Radovicka, drejtoreshë e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Transportit, Infrastrukturës dhe Zhvillimit Urban; zotin Maksim Et’hemaj, drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil dhe zonjën Edlira Kraja, drejtoreshë Juridike e Autoritetit të Aviacionit Civil.

Mirë se keni ardhur!

Të nderuar kolegë, ne e kemi miratuar projektligjin në parim, kurse sot kemi miratimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1 të projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Për sa i përket nenit 5, në seancën e kaluar kemi pasur një sugjerim, që nuk e di sa do të pranohet nga kolegët dhe përfaqësuesit e ministrisë. Në paragrafin e dytë thuhet: “Këshilli i drejtues është organ kolegjal i përbërë nga pesë anëtarë”.

Zoti Qefalia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I qëndroni këtij propozimi apo të jetë me pesë anëtarë?

Hantin Bonati - Po, ne i qëndrojmë këtij propozimi që kemi bërë.

Nasip Naço - Ka ndonjë mendim nga kolegët?

Xhemal Qefalia – Jo.

Nasip Naço - Kush është dakord me nenin 5, sipas variantin të paraqitur? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 6 të projektligjit? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 7? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 8? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 9? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Për sa i përket nenit 10, ka pasur një sugjerim: “ministri, në zbatim të pikës 2 të këtij neni, mund të vendos pezullim deri në 3 muaj”. Doni ta lini “deri në 3 muaj” apo siç është varianti i paraqitur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hantin Bonati - Nëse lihet pa afat, se varet nga tipologjia e vendimmarrjes, sikurse është propozuar tek akti ynë, ne gjykojmë se do të ishte më e përshtatshme. Deri në përfundimin e procesit të verifikimit, sepse tipologjinë ...

Nasip Naço - Anëtarin e këshillit drejtues e emëron Këshilli i Ministrave dhe ministri nuk mund ta pezullojë pa afat dhe të dalë mbi Këshillin e Ministrave. Pra, mund ta lërë 6 muaj apo 1 vit.

Hantin Bonati E lëmë 6 muaj.

Nasip Naço – Kolegë, keni ndonjë mendim?

Kush është dakord me nenin 10, sipas variantit të paraqitur? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 11? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 12? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 13? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 14? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Për sa i përket nenit 15, në seancën e kaluar ka pasur një sugjerim që te kriteret për emërimin e drejtorëve ekzekutivë, germa “c” të hiqet shprehja “në aviacionin civil”.

Hantin Bonati – Ne i qëndrojmë propozimit tonë, sepse mendojmë se është e rëndësishme dhe e domosdoshme që eksperiencia e drejtorit të Përgjithshëm të jetë në Aviacionin civil.

Nasip Naço - Faleminderit!

Kush është dakord me variantin e paraqitur në nenin 15, sipas qeverisë? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 16? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Për sa i përket nenit 17, ka pasur një sugjerim për ndryshim në pikën 4 dhe të thuhet: “I nënshtrohet kontrollit të figurës dhe pajiset me certifikatë sigurie, sipas legjislacionit në fuqi”.

Kledia Ngjela - Meqenëse legjislacioni shqiptar parashikon dy lloj kontrollesh, një mbi dosjet dhe një sipas informacionit të klasifikuar, sugjerimi ynë është: “Punonjësit e Autoritetit që mbajnë pozicione të lidhura me funksione specifike dhe që kanë akses në zonat me siguri të kufizuar i nënshtrohen kontrollit sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar”.

Nasip Naço - Kush është dakord me sugjerimin e bërë nga përfaqësuesja e ministrisë për pikën 4 të nenit 17?

(Diskutime pa mikrofon)

Po, zoti Pendavinji.

Ilirian Pendavinji – *(Nuk dëgjohet.)*

Nasip Naço – Propozimi që kam bërë është: “I nënshtrohet kontrollit të figurës dhe pajiset me certifikatë sigurie sipas legjislacionit në fuqi”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Hedhim në votim nenin 17, me ndryshimet e propozuara.

Kush është dakord me nenin 17, me ndryshimin në pikën 4? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 18? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 19? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 20? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 21? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 22? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 23? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 24? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 25? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 26? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 27? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 28? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 29? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 30? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për organizmin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”, me ndryshimin që kemi rënë dakord për t’ia propozuar komisionit përgjegjës.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit për prezencën!

Faleminderit, kolegë deputetë!

Po, zoti Xhaferraj.

Ferdinant Xhaferraj - Është depozituar një kërkesë për të thirrur në seancë dëgjimore në komision ministrin e Mbrojtjes për ta pyetur për problematikat e vëna re së fundmi. Problemi i parë lidhet me pronat e ushtrisë, për të cilin, në vend që të shikonim një reagim në drejtimin e duhur të qeverisë, shikojmë që qeveria ka kaluar një projektligj që e zhvesh Policinë Ushtarake nga të gjitha objektivat e saj për mbrojtjen e pronave të ushtrisë. Problemi i dytë lidhet me situatën e rënduar të zjarreve, ndërkohë që me shumë sakrifica dhe me paratë e taksapaguesve shqiptarë vite më parë u blenë katër helikopterë “Cougar”, por sot asnjëri nuk është në gjendje pune dhe ne presim të vijë helikopterë nga Greqia për përballimin e situatës në ishullin e Sazanit.

Do t'i lutesha kryetarit të komisionit të na bënte me dije për këtë kërkesë tonën, sepse akoma nuk jemi njoftuar ditën dhe orën kur ministri do të vijë në komision.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Xhaferraj!

Kërkesa që ju keni depozituar në komision me firmat përkatëse, siç e kërkon edhe Rregullorja, me mbi shtatë anëtarë, është depozituar dhe i është dërguar edhe ministrit, zotit Peleshi. Është lënë një seancë për nesër, por nuk është konfirmuar nga zoti Peleshi për shkak të agjendës së tij. Nëse nuk do të zhvillohet dot nesër, seanca mund të ngelet për javën tjetër. Gjithsesi, presim konfirmimin deri në orën 12:00 nga zoti Peleshi për nesër.

Të mos i bëjmë komente as zjarrit, as helikopterit.

Ferdinant Xhaferraj – Unë nuk i bëj komente as zjarrit dhe as helikopterit, por i bëj koment komentit tuaj. Unë nuk mendoj se është kërkesa e opozitës. Që në ditët e para në këtë komision kemi thënë që duhet të funksionojmë si Komisioni i Sigurisë Kombëtare, ndaj unë e quaj këtë si kërkesë të komisionit. Pavarësisht se kërkesa është firmosur nga shtatë anëtarë të opozitës, mendoj që edhe ju si kolegë të maxhorancës në këtë komision duhet të na bashkoheni, sepse shumë nga ju janë me formim ushtarak. Pronat e ushtrisë janë problem i gjithë komisionit dhe jo vetëm i opozitës, ashtu siç edhe situata e zjarreve është problem i gjithë komisionit dhe nuk është problem vetëm i opozitës. Kështu e konceptoj unë, duke pasur parasysh edhe historikun e këtyre muajve në këtë komision, ku problematikat ne i kemi parë si kombëtare dhe jo të opozitës apo maxhorancës.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti Xhaferraj!

Kërkesa juaj është bërë për ndryshimet që mund të bëhen në ligjin “Për Policinë Ushtarake” dhe besoj se për këtë gjë është kërkuar të thirret edhe ministri. Pasi të mbarojnë diskutimet për këtë kërkesë të bëra nga ana juaj, jeni 360 gradë të lutur të bëni pyetje, diskutime dhe të shfrytëzoni çdo mundësi që ka opozita.

Opozita nuk ka fjalën, ajo është alternativë, kështu që, jemi të hapur për të qenë bashkë me ju, por nuk mund të hedhim fall se çfarë keni menduar ju dhe çfarë do të diskutoni ju. Në varësi të diskutimit tuaj, të pyetjeve, të qëndrimit tuaj dhe të ministrit, ne do të dimë të orientohemi gjithsecili si individ, por edhe komisioni i përbërë nga pjesa e maxhorancës.

Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia - Kam një koment.

Kërkesa që ka paraqitur grupi i Partisë Demokratike dhe shtatë kolegët e komisionit tonë është e bazuar në Rregullore. Normalisht, nga ana e kryetarit është vepruar në mënyrë korrekte pasi sekretaria e komisionit ia ka përcjellë menjëherë kërkesën organit kompetent, që në rastin konkret është ministri i Mbrojtjes. Në asnjë rast nuk thuhet që kërkesa është emergjente dhe ministri duhet të paraqitet menjëherë në komision.

Kështu që, jemi brenda logjikës së Rregullores, por edhe të praktikës që ka ky komision. Natyrisht, është e vërtetë ajo që thoni ju. Pavarësisht se janë shtatë, për aq kohë sa është përcaktuar numri edhe në mbledhjet e komisioneve që është i rregullt, në momentin e parë që do të paraqitet, do të njoftoheni. Mendoj që sjellja dhe veprimi i kryetarit është tepër korrekt pasi shkresa është përcjellë dikasterit të Ministrisë së Mbrojtjes. Kështu që, ne jemi në pritje dhe në momentin që do të njoftohemi do të jemi këtu të gjithë për të diskutuar rreth problematikës që ju keni ngritur në kërkesën që keni paraqitur në komision.

Faleminderit!

Ferdinant Xhaferraj – Unë e falënderoj kolegun Qefalia që e solli si problematikë për ta diskutuar dhe për ta vendosur njëherë e përgjithmonë.

Jemi në një situatë që realisht, edhe ju e kuptoni, të gjitha pushtetet kontrollohen nga kjo maxhorancë dhe mundësia e abuzimit dhe e arrogancës është shumë e madhe. I vetmi mekanizëm që sot mund të kontrollojë dhe mbikëqyrë si Ministrinë e Brendshme, ashtu edhe Ministrinë e Mbrojtjes, jemi ne si komision. Në qoftë se ne nuk ngrihem në lartësinë e detyrës sonë, ju e kuptoni çfarë problematike hapet. Nëse vjen një kërkesë nga opozita, unë do t’i thosha kryetarit të komisionit, që në çdo rast tjetër, nuk është ky komision në varësi të agjendës së ministrit. Kryetari

duhet t'i thoshte "Të mërkurën në orën 10:00 duhet të vish në komision" dhe nëse ai do të kishte arsye, do t'i jepte. Ne mbikëqyrim dhe si komision e kuptoni ku jemi në raport me ministrin. Nuk ka asnjë arsye që ju të perceptoheni në raport vasaliteti si me ministrin e Mbrojtjes, ashtu edhe me ministrin e Rendit. Kërkesa nga komisioni duhet të ishte: "Të mërkurën në orën 12:00 duhet të jeni në komision". Kjo i jep autoritet komisionit dhe kjo e vë 100% komisionin në ushtrim të attributeve të veta si organ mbikëqyrës dhe kontrollues mbi ministrinë.

Nasip Naço - Zoti Xhaferraj, unë besoj se nuk është orari që përcakton vasalitetin ose varësinë e komisionit nga ministri. Ministri ka pasur një agjendë. Kërkesën tuaj unë e kam transmetuar menjëherë, por jam informuar që, për shkak të agjendës së paracaktuar të ministrit, vetëm dita e nesërme ishte e mundur për zhvillimin e seancës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra, por kërkesa është nisur menjëherë sapo erdhi dhe ne kemi kërkuar konfirmim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Çelaj, e kam deklaruar në këtë komision që nëse nuk bëheni asnjëherë shtatë, por gjashtë, votën e shtatë do ta keni nga mua për çdolloj kërkesë që do të keni. Nëse kërkesa është bërë për ligjin "Për Policinë Ushtarake" dhe tani dilni te zjarri në Sazan, është çështja juaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, pra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po të ishte kjo, mund ta lija për javën tjetër, por ju thashë që e kam kërkuar për nesër, për shkak të agjendës që kemi edhe ne si deputetë, për shkak të agjendës që ka edhe ministri. Nëse ju doni të vendosim një seancë fiktive për në orën 12:00, por ministri nuk vjen, hajde ta bëjmë, por unë jam korrekt në atë që kërkoj. Deri në orën 12:00 ministri do na kthej përgjigje për nesër. Nëse nuk është e mundur, do të lihet për javën tjetër në mënyrë që të biem dakord të gjitha palët për prezencën tonë dhe të ministrit.

Ferdinant Xhaferraj – Kam edhe diçka tjetër, zoti kryetar.

Nasip Naço - Nëse doni zëvendësministrin nesër, unë jam dakord.

Ferdinant Xhaferraj - Kërkesa është bërë për ministrin. Të mos vendosim në pozitë të vështirë kolegët aty, sepse ata janë zyrtarë të shtetit dhe të mos nxjerrim nga zyra titullarë të tjerë të institucionit.. Nëse nuk vjen ministri ...

Nasip Naço - Dakord. Prandaj, na duhet të rakordojmë me agjendën e ministrit. Nëse doni zëvendësministrin, e bëjmë që nesër, në çfarëdolloj ore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit dhe do të jemi në pritje!

MBYLLET MBLEDHJA